



Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në pajtim me Vendimin A.nr. 629/2023 të datës 09.06.2023, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHC), pas rishqyrtimit të aplikacionit të datës 21.03.2023 të z. Muharrem Arifi për pozitën Zëvendës drejtor i përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me nr. reference RN00010838, nxjerr këtë:

NJOFTIM

Aprovohet aplikacioni i z. Muharrem Arifi i datës 21.03.2023 për pozitën Zëvendës drejtor i përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me nr. reference RN00010838 të publikuar me datë 13.02.2023 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Arsyetim

Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 13.02.2023 ka shpallur konkurs me nr. reference RN00010838 për pozitën Zëvendës drejtor i përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Z. Muharrem Arifi për pozitën në fjalë ka aplikuar me aplikacionin me nr. Reference RAN0012168 me datë 21.03.2023.

Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pasi shqyrtoi aplikacionin RAN0012168 të datës 21.03.2023 të z. Muharrem Arifi dhe të gjitha dëshmitë e bashkangjitura në aplikacionin e tij, me vendim DM 105/2023 të datës 31.03.2023, konstatoi se z. Muharrem Arifi nuk kualifikohet për procedurë të mëtejme të rekrutimit.

Z. Muharrem Arifi me datë 03.04.2023 pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore ka paraqitur ankesë lidhur me mos kualifikimin e tij për konkurrim të mëtejme.

Pas shqyrtimit të ankesës, Departamenti i Burimeve Njerëzore, me Vendimin me nr. DM 112/2023 të datës 05.04.2023 ka refuzuar ankesën e z. Muharrem Arifi.

Z. Muharrem Arifi, me datë 12.04.2023 paraqet ankesë në KPMSHC kundër Vendimit me nr. 112/2023 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Me datë 09.06.2023 (të pranuar në AKP me datë 16.06.2023) KPMSHC me vendimin A.nr. 629/2023 aprovon si të bazuar ankesën e datës 12.04.2023 e parashtruar nga ankuesi z. Muharrem Arifi.

Andaj, pas rishqyrtimit të aplikacionit të z. Muharrem Arifi, Departamenti i Burimeve nxjerr këtë njoftim.

Prishtinë, 20.06.2023

Liana Xharra – Tolaj

Drejtor i Burimeve Njerëzore

Njoftimi i dërgohet Z. Muharrem Arifi